



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Përgjithshëm**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Doculive 201700704/2**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda:**            *Rekomandojmë rillogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë të shtetasës S.K.*

**Drejtuar:**        **Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore**

**BERAT**

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasja S.K, në përmbajtjen e së cilës ankohet për llogaritjen jo të drejtë të masës së pensionit të pleqërisë dhe kërkon rillogaritjen e saj.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Sipas shpjegimeve të saj, shtetasja S.K ka dalë në pension të parakohshëm në vitin 1994, ka punuar në Kombinatin e Tekstileve Berat, punë të Kategorisë së 7. Llogaritja e pensionit nuk është bërë e saktë. I është caktuar pension i pleqërie i plotë në shumën 12254 lekëve në muaj, ndërkohë që kolegja e saj në kushte të njëjta pune merr pension në shumën e 14005 lekë në muaj.

Ankuesja pretendon se bazuar në kategorinë e punës së bërë, masa e pensionit që gëzon duhet të jetë më e lartë nga sa i është caktuar. Ajo shprehet se nga ana e institucionit tuaj llogaritja e pensionit është bërë si punë e kategorisë së parë dhe jo të 7.

Për t'iu mundësuar rillogaritja e pensionit të pleqërisë, ka kërkuar ndërmjetësimin tonë institucional.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë*

*rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se : "Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",*

### **REKOMANDOJMË:**

Rillogaritjen e masës së pensionit të shtetases S.K.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit",*

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

**K O M I S I O N E R I**

**Ermir KAPEDANI**